



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. 4965 Prot.

Tiranë, më 29.05.2019

**Lënda:** Kërkesë për plotësim dokumentacioni

**ZNJ. NADIRE MEHMET EMINI**  
Adresa: Njësia Administrative Xharë, Konispol

**Për dijëni:** **KËSHILLIT TË BASHKISË KONISPOL**  
Adresa: Bashkia Konispol

**PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**  
Adresa: Rr. Bulevardi "Zhan D' Ark", nr. 11, Tiranë

Me shkresën nr. 23 prot., datë 29.03.2019, Këshilli i Bashkisë Konispol, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Këshill, vakancë kjo e krijuar nga Këshilltari, z. Ervis Lole Danga, propozuar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Konispol, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 04, znj. Florida Robert Mustafa.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2271 prot., datë 09.04.2019, i është drejtuar znj. Florida Robert Mustafa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidate vijuese e listës shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Konispol, të cilës i kalon mandati i Këshilltarit.

Znj. Florida Robert Mustafa brenda afatit të përcaktuar datës 19.04.2019, nuk ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", kreu II, pika 3, parashikon se: "Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, atëherë organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 06, znj. Marinela Sulo Papa.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2271/1 prot., datë 25.04.2019, i është drejtuar znj. Marinela Sulo Papa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidate vijuese e listës shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Konispol, të cilës i kalon mandati i Këshilltarit.



Znj. Marinela Sulo Papa, brenda afatit të përcaktuar datës 05.05.2019, nuk ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 08, znj. Shpresa Ali Selmani.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2890 prot., datë 11.05.2019, i është drejtuar znj. Shpresa Ali Selmani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidate vijuese e listës shumëmemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Konispol, të cilës i kalon mandati i Këshilltarit.

Znj. Shpresa Ali Selmani nuk ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vazhdojë procedurën me kandidatin e rradhës me numër rendor 10 (dhjetë), znj. Nadire Mehmet Emini.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", kreu II, pika 3, parashikon se: "Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, atëherë organi kompetent e njofton atë që, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitojë të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj. Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumëmemërore për këshillin bashkiak për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Këshillin e Bashkisë Konispol, kandidati i listës shumëmemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, znj. Nadire Mehmet Emini, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmangët plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me kreun II, pika 7, dhe kreun III, pika 2, e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

